



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Numri i lëndës: 2020:103771
Datë: 23.05.2024
Numri i dokumentit: 05727945

KA.nr.407/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli-Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit Agjencia e Kosovare e Privatizimit, kundër të paditurës Agjencia Kadastrale e Kosovës, me kërkesëpadi për anulimin e vendimit me Nr.03/1606/16 të datës 04.08.2020 të nxjerrë nga e paditura, konform nenit 13 paragrafi 7 të Ligjit nr. 08/I-015 për Gjykatën Komerciale (LGJK), jashtë seancës, më datë 22.05.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat Shkalles se Pare - Departamentit për Çështje Administrative shpallet jo kompetente për ta gjykuar këtë çështje administrative
- II. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi lënda i dorëzohet Gjykatës Themelore në Prishtinës Departamentit për Çështje Administrative, si gjykatë kompetente për ta gjykuar këtë çështje juridike administrative.

A r s y e t i m

Me datë 27.08.2027 paditësi Agjencia e Kosovare e Privatizimit, Gjykatës Themelore në Prishtinës Departamentit për Çështje Administrative ka parashtruar padi kundër të paditurës Agjencia Kadastrale e Kosovës, me kërkesëpadi për anulimin e vendimit me Nr.03/1606/16 të datës 04.08.2020 të nxjerrë nga e paditura. Lënda është e evidentuar me nr. A. 1420/20.

Gjykata Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative e ka dërguar lëndën në Gjykatën Komerciale Departamenti Administrativ pa e shqyrtuar kompetencën lëndore të çështjes.

Pas shqyrtimit paraprak të padisë Gjykata Komerciale Departamenti Administrativ vlerësoj kompetencën lëndore sipas detyrës zyrtare mbështetur në nenin 19 të Ligjit për Procedurën Kontestimore lidhur me nenin 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe vlerësoj se nuk është kompetent në pikëpamje lëndore për ta gjykuar këtë çështje.

Sepse padi në fjalë është parashtruar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit në cilësi të autoritetit publik e cila nuk është shoqëri tregtare, prandaj kjo gjykatë vlerëson se nuk ka kompetencës lëndore për të gjykuar këtë çështje, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale që përcaktojnë se *“1. Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: kontestet administrative të iniciuara nga shoqëritë tregtare kundër vendimeve përfundimtare në procedurë administrative”* lidhur me par. 5 që përcakton se: *“Të gjitha çështjet e përcaktuara në nën-paragrafin 1.12 të paragrafit 1 të këtij neni do të trajtohen në shkallë të parë nga Departamenti për Çështje Administrative.”* Gjithashtu në nenin 3 par. 1, nën par. 1.10 të Ligjit për Gjykatën Komerciale është përcaktuar përkufizimi si në vijim: *“Shoqëritë Tregtare – të gjitha shoqëritë tregtare të përcaktuara në Ligjin për Shoqëritë Tregtare”*.

Prandaj, bazuar në dispozitat e lartcekura, Departamenti për Çështje Administrative pranë Gjykatës Komerciale është kompetent për shqyrtimin e kontesteve administrative të iniciuara vetëm nga shoqëritë tregtare, kundër vendimeve përfundimtare në procedurë administrative, prandaj kjo gjykatë vlerëson se kompetente për shqyrtimin e kësaj çështje është Departamenti Administrativ i Gjykatës Themelore në Prishtinë.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.407/22, datë 22.05.2024

Numri i lëndës: 2020:103771
Datë: 23.05.2024
Numri i dokumentit: 05727945



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar e drejta e ankesës, në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatën Komerciale në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.